

Në bazë të nenit 27 të Statutit të Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore, nenit 66 paragrafi (6) të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/20 dhe 294/21) dhe nenit 10 të Rregullores për procesin e vlerësimit të ndikimit të mbrojtjes së të dhënave personale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 122/2020), Drejtori i Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore miratoi

## METODOLOGJIA PËR ZBATIMIN E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT TË MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

### **1.Çka paraqet Vlerësimi i ndikimit të mbrojtjes së të dhënave personale (në tekstin e mëtutjeshëm: VNMDHP)**

VNMDHP është një proces i projektuar për të përshkruar përpunimin e të dhënave personale, për të vlerësuar domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e tij dhe për të ndihmuar në menaxhimin e rreziqeve për të drejtat dhe liritë e personave fizikë që do të lindin nga përpunimi përmes vlerësimit të tyre, si dhe për të parashikuar masa për ballafaqim me këto rreziqe.

### **2. Kur kryen VNMDHP**

Vlerësimi i detyrimit për zbatimin e VNMDHP kryhet në varësi të kushteve të përcaktuara në nenin 39 paragrafi (1) të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe në përputhje me nenin 3 dhe nenin 5 të Rregullores për procesin e vlerësimit të ndikimit të mbrojtjes së të dhënave personale.

VNMDHP është e detyrueshme të kryhet para fillimit të përpunimit të të dhënave personale, përkatësisht kur krijohen procese të reja të përpunimit të të dhënave personale, dhe veçanërisht kur futen teknologji të reja për përpunimin e të dhënave personale.

VNMDHP kryhet para se të bëhen ndryshime të rëndësishme në disa operacione ekzistuese të përpunimit të të dhënave personale.

Gjatë zbatimit të VNMDHP, Drejtori emëron personat përgjegjës për zbatimin e VNMDHP në varësi të llojit dhe përpunimit të të dhënave personale. Rekomandohet që në këtë proces të përfshihen persona nga Departamenti i TIK-ut, persona-ekspertë nga fusha për të cilën zbatohet VNMDHP. Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale gjithashtu duhet të përfshihet në procesin e VNMDHP.

### **3. Kriteret e VNMDHP dhe përmbajtja**

NPRRSH në përcaktimin se cilat operacione të përpunimit sigurisht do të rezultojnë me rrezik të lartë dhe për të cilat VNMDHP është i detyrueshëm duhet të marrë parasysh të paktën një nga kriteret e përcaktuara në nenin 4 të

Rregullores për vlerësimin e procesit të ndikimit të mbrojtjes së të dhënave personale.

VNMDHP duhet të përmbajë:

- përshkrim të operacioneve të parashikuara të përpunimit dhe qëllimet e përpunimit;
- vlerësimin e nevojës dhe proporcionalitetit të përpunimit;
- vlerësimin e rreziqeve për të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave personale;
- masat e parashikuara për menaxhimin e rreziqeve dhe demonstrimin e përputhshmërisë me rregulloret për mbrojtjen e të dhënave personale.

#### 4. Metodologjia e zbatimit të VNMDHP

Metodologjia e zbatimit të VNMDHP përmban:

- **Përshkrim sistematik i procesit të përpunimit të parashikuar**
  - natyra, fushëveprimi, konteksti dhe qëllimet e përpunimit;
  - të dhënat personale të marrësve dhe periudhën e ruajtjes së të dhënave personale;
  - përshkrim funksional të operacionit të përpunimit;
  - identifikimi i mjetet nga të cilat varen të dhënat personale (pajisjet, programet softuerike, rrjetet, personat, dokumentet në formë të shkruar ose kanalet për dërgimin e dokumenteve në formë të shkruar); dhe
  - përputhshmëria me kodet e miratuara të sjelljes.
  
- **Nevoja dhe proporcionaliteti i vlerësuar**
  - janë përcaktuar masat e parashikuara për harmonizimin e rregullativave për mbrojtjen e të dhënave personale, duke i pasur parasysh:
    1. Masat që kontribuojnë në proporcionalitetin dhe domosdoshmërinë e përpunimit në bazë të:
      - objektiva specifike, të qarta dhe legjitime,
      - ligjshmërinë e përpunimit,
      - të dhëna personale të përshtatshme dhe relevante dhe të kufizuara në ato që janë të nevojshme dhe
      - periudha e kufizuar e ruajtjes.
  
    2. Masat që kontribuojnë në të drejtat e subjekteve të të dhënave:
      - informacion që i është dhënë subjektit të të dhënave personale,
      - të drejtën për qasje dhe transportueshmëri të të dhënave,
      - të drejtën për korrigjim dhe fshirje,

- të drejtën për kundërshtim dhe kufizim të përpunimit,
- marrëdhëniet me procesorët,
- masat mbrojtëse në lidhje me transferimin, dhe
- konsultim paraprak.

- **Janë të kontrolluara rreziqet për të drejtat dhe liritë e të anketuarve (masat e parashikuara për ballafaqimin me rreziqet)**
  - vlerësohet burimi, natyra, specifika dhe serioziteti i rrezikut ose në mënyrë më të detajuar, për secilin rrezik (qasje e paautorizuar, ndryshimet e padëshiruara dhe humbjen e të dhënave) nga pikëpamja e subjekteve të të dhënave personale,
  - janë marrë parasysh burimet e rreziqeve,
  - janë përcaktuar efektet e mundshme në të drejtat dhe liritë e të dhënave personale, ndër të tjera, në rast të qasjes së paautorizuar, ndryshimeve të padëshiruara dhe humbjes së të dhënave,
  - është vlerësuar mundësia dhe serioziteti, dhe
  - parashikohen masa të caktuara për eliminimin e këtyre rreziqeve.
  
- **Palët e interesuara të përfshira**
  - kërkohet ndihmë nga oficeri dhe
  - kur është e përshtatshme, janë kërkuar mendimet e subjekteve të të dhënave personale ose përfaqësuesve të tyre.

## 5. Procedurat e VNMDHP

VNMDHP kryhet në katër faza edhe atë:

1. Përkufizimi i kontekstit – në fazën e parë përcaktohet konteksti i përpunimit dhe specifikohen, përkatësisht përshkruhen të paktën informacionin e mëposhtëm:

- mbledhja e të dhënave personale;
- qëllimi i përpunimit;
- ecuria e të dhënave;
- metoda(t) e marrjes së të dhënave;
- mënyra dhe mjetet e përpunimit të të dhënave (pajisjet e përdorura, rrjetet, burimet njerëzore, etj.);
- subjektet e përfshira në përpunim (kontrollorët, përpunuesit, përdoruesit, etj.) dhe
- afati i ruatjes.

2. Analiza e rrezikut- në fazën e dytë, identifikohen kërcënimet (rezultatet të padëshiruara), si dhe përcaktohet probabiliteti dhe ndikimi (pasoja) i realizimit të secilit rrezik.

Rreziku shprehet si një funksion i probabilitetit të rezultatit të pafavorshëm (kërcënim) dhe ndikimit (pasojë) të rezultatit të pafavorshëm nëse ndodh.

Rreziku = (gjasat e kërcënimit që ndodh) x (shkalla e ndikimit)

Ndikimi mund të jetë:

- i ulët, kur personat fizik mund të përballen me disa shqetësime të vogla, të cilat do t'i tejkalojnë pa problem;

- i mesëm, kur personat fizik mund të përballen me vështirësi të konsiderueshme, të cilat do të mund t'i tejkalojnë pavarësisht vështirësive të caktuara;

- i lartë, kur personat fizik mund të përballen me pasoja të rëndësishme, të cilat duhet të jenë në gjendje t'i tejkalojnë, por me vështirësi serioze dhe

- shumë i lartë, kur personat fizik mund të përballen me pasoja të rëndësishme apo edhe të pakthyeshme, të cilat nuk ka gjasa të jenë në gjendje t'i tejkalojnë.

Vlerësimi i rrezikut kryhet sipas parimeve të mbrojtjes së të dhënave personale.

3. Menaxhimi i rrezikut – në fazën e tretë duhet të mbulojë masat mbrojtëse, përkatësisht masat e sigurisë dhe mekanizmat e projektuar për të zvogëluar rrezikun në një nivel të pranueshëm, si dhe të sigurohet mbrojtja e të dhënave personale dhe të dëshmohet harmonizimi me rregullativat për mbrojtjen e të dhënave personale.

Masat, si dhe vlerësimi i rrezikut, duhet të ndahen sipas parimeve të mbrojtjes së të dhënave personale.

4. Përgatitja e raportit nga zbatimi i VNMDHP – Në raport dokumentohen të gjitha fazat të zbatimit të VNMDHP.

Raporti nga zbatimi i VNMDHP në veçanti përmban: përshkrimin e procesit të përpunimit, personat e brendshëm dhe të jashtëm të përfshirë në procesin e zbatimit të VNMDHP, analizën e rrezikut, masat e përcaktuara të menaxhimit të rrezikut, përmbledhjen/përfundimin, plani aksional, mendimin e zyrtarit dhe personave të tjerë të përfshirë në proces, miratimin e VNMDHP nga funksioneri ose personi përgjegjës të kontrolluesi.

## 6. Shpallja

Kjo metodologji hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj dhe publikohet në UEB faqen e Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore.

DREJTOR

-----

Ejup Rustemi